



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1154/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Arben Kastratit kandidat për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër komisionarëve të vendvotimit 2727b pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvend komunal nga KQZ-a për shkak të mungesave të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Arben Kastratit nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Vushtrri kandidat për kuvendin komunal të Vushtrrise.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Arben Kastrati kandidat për asamble komunale në Vushtrri nga rradhët e AAK-së me të cilën dyshon se në vendvotimin 2727b ka pasur vota por se votat e tij dhe se votat e tij i mungonë pasi që sipas tij këto u janë bartur anëtarëve të afërt me komisionarët e këtij vendvotimi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore nga ana e Arben Kastratit se i mungojnë votat dhe se i janë bartur kandidatëve tjerë, PZAP-i konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova për tu vërtetuar pretendimet e tilla ankimore dhe me këtë rast

nuk është arritur që për asnjë moment që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1154/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.